



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI**

**VENDIM**

**Nr. 245, datë 21.12.2020**

**MBI**

**ZGJATJEN E AFATIT TË VENDIMMARRJES SË BORDIT TË ERE-S NË LIDHJE  
ME KËRKESËN E SHOQËRISË “GREENTECH ENERGY SYSTEMS” SH.P.K.,  
PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË  
ELEKTRIKE**

Nisur nga sa më sipër, në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “d” të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 53, pika 3, të “Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15, të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.06.2016, bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 21.12.2020, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 135/15 prot, datë 17.12.2020, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, lidhur me “Zgjatjen e afatit të vendimmarrjes së Bordit të ERE-s në lidhje me kërkesën e shoqërisë “GREENTECH ENERGY SYSTEMS” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

**Konstatoi se:**

- Shoqëria “GREENTECH ENERGY SYSTEMS” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1155 Prot, datë 02.11.2020, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 183, datë 13.11.2020, vendosi: “Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Greentech Energy Systems” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5 vjeçar”.
- Në vijim të kësaj vendimmarrje u krye njoftimi në median e shkruar me shkresën me nr. 62/35 prot., datë 16.11.2020, për fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
- Me shkresën nr. 1155/1 prot., datë 24.11.2020, ERE iu drejtua shoqërisë duke i njoftuar: Fillimin e procedurës dhe kërkoi plotësimin e dokumentacionit të munguar nga aplikimi i saj.
- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1155/2 prot., datë 17.12.2020, shoqëria ka paraqitur kërkesën për “Shtyrje të afatit për plotësimin e dokumentacionit, për shkak të situatës së krijuar nga COVID-19”.
- Në nenin 14, pika 2 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike, përcaktohet se për centralet e lidhur drejtëpërdrejtë me rrjetin e

shpërndarjes, dhe për të gjitha licencat e tjera bordi merr vendim jo më vonë se 30 ditë pune nga data e publikimit të parë të njoftimit në shtyp për aplikimin në shtyp, ndaj për kërkesën e shoqërisë “GREENTECH ENERGY SYSTEMS” sh.p.k., bordi duhet të marrë vendimin përfundimtar brenda datës 31.12.2020.

- Në nenin 53, pika 3, të Kodit të Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë përcaktohet se:
  - *Afati i caktuar nga organi publik mund të zgjatet me kërkesë të justifikuar të palës së interesuar, të paraqitur përpara mbarimit të afatit.*
- Kërkesa e shoqërisë për zgjatje të afatit të depozitimit të dokumentacionit përkatës është bërë përpara mbarimit të afatit për vendimmarrjen përfundimtare të bordit të ERE-s.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

#### **Vendosi:**

1. Të zgjasë me 30 ditë punë afatin e vendimmarrjes në lidhje me kërkesën e shoqërisë “GREENTECH ENERGY SYSTEMS” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE**  
**Petrit AHMETI**